EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6461
E enjte, 11 nëntor 2021
çmimi 0.40 €

KQZ-ja vendos të rinumërohen edhe 155 vendvotime për kuvende komunale

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDOJNË REAGIMET PËR MOSFTESËN E KOSOVËS NË "SAMITIN E DEMOKRACISË"

FAQE 4-5

KOSOVA MERITON TË JETË NË 'SAMITIN E DEMOKRACISË'

Raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovën, Viola von Cramon, e ka vlerësuar gabim të administratës amerikane mosftesën e Kosovës në "Samitin e demokracisë", i cili organizohet më 9 dhe 10 dhjetor nga presidenti amerikan Joe Biden. Ajo ka thënë se Kosova e meriton të jetë pjesë e këtij samiti. Për mungesën e kësaj ftese është deklaruar edhe qeveria. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se nuk ka asgjë për t'u shqetësuar se Kosova nuk është ftuar nga ShBA-ja në këtë samit

Arrin varianti 'Delta Plus' në Kosovë, prej 70 mostrave të testuara, 12 pozitive

FAQE 7

RUTTE NGA TIRANA PËRKRAH HAPJEN E NEGOCIATAVE, NGRE SHQETËSIMIN PËR NDËRHYRJET RUSE NË BALLKAN

FAQE 7

AKTUALE

RAPORTUESJA PËR SHQIPËRINË KËRKON HAPJEN E NEGOCIATAVE ME BE-në F. 2

KONJUFCA KËRKON NGA KOMISIONET PËRSHPEJTIM TË PROCEDIMIT TË PROJEKTLIGJEVE F. 3

POLICIA ARRESTON TRE PERSONA TË DYSHUAR PËR FALSIFIKIM PARASH F. 6

EKONOMI

KURTI PREMTON 100 MILIONË EURO INVESTIME NË BUJQËSI F. 8

PROMOVIMI I NDËRMARRËSISË NË KOSOVË, BIZNESET KËRKOJNË QË SHKOLLAT TË PËRGATITIN KUADRO TË REJA F. 8

SPORT



MORINA: DO TË LUAJMË PËR FITORE KUNDËR NORVEGJISË DHE DANIMARKËS F.10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ĐUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Raportuesja për Shqipërinë kërkon hapjen e negociatave me BE-në

TIRANË, 10 NËNTOR - Raportuesja për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Isabel Santos, tha se Tirana zyrtare ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për t'i nisur negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Pas një vizite treditore në Shqipëri, Santos lëshoi një deklaratë për media, ku u bëri ftesë të gjitha forcave politike në Shqipëri që ta vazhdojnë dialogun, në mënyrë që t'i ndihmohet vendit të ecë përpara në procesin e integrimeve evropiane.

Santos, po ashtu, u ka bërë ftesë vendeve anëtare të BE-së që, më në fund, ta caktojnë datën për konferencën e parë ndërqeveritare, në të cilën formalisht do të hapeshin negociatat për anëtarësim. "Parlamenti Evropian ka qenë shumë i qartë për një kohë të gjatë. Ka njohur progresin që ka bërë Shqipëria dhe ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme avancimin e saj në procesin e anëtarësimit", ka thënë Santos, duke shtuar se edhe Komisioni Evropian, në Raportin e fundit të Progresit, ka konstatuar se janë përmbushur të gjitha kriteret dhe ka rekomanduar hapjen e negociatave me Shqipërinë.

Përveç Shqipërisë, në pritje të fillimit të negociatave të anëtarësimit me BE-në është edhe Maqedonia e Veriut, e cila, po ashtu, sipas Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, i ka përmbushur të gjitha kushtet. Megjithatë, vendimi për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut ka ngecur në Këshillin e BE-së, pasi Bullgaria ka vendosur veto për shkak të mospajtimeve që ka me Shkupin zyrtar. Për këtë arsye, disa shtete anëtare të BE-së kanë kundërshtuar që të hapen negociatat vetëm për Shqipërinë.

Në Bullgari, të dielën, më 14 nëntor, mbahen zgjedhjet parlamentare dhe shpresat janë që pas zgjedhjeve të ketë përparim drejt arritjes së një zgjidhjeje, që do të hiqte pengesat për hapjen e negociatave në mes të BE-së dhe Maqedonisë së Veriut. Moshapja e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut edhe nga shumica e zyrtarëve të BE-së po shihet si e dëmshme për besueshmërinë e bllokut evropian në rajon.

Escobari diskuton me Schmidtin për "mbrojtjen e Marrëveshjes së Dejtonit"

SARAJEVË, 10 NËNTOR - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, njëherësh i dërguari për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në përfundim të vizitës së tij në Bosnje dhe Hercegovinë, ka biseduar me përfaqësuesin e lartë ndërkombëtar, Christian Schmidt, për mundësitë e "mbrojtjes së Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit".

Në një shkrim të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Sarajevë, thuhet se Escobari shprehu kënaqësinë që me përfaqësuesin e lartë Schmidt pati mundësinë të diskutonte për një angazhim të përbashkët në mbrojtjen e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit dhe rritjen e funksionalitetit në Bosnje dhe Hercegovinë.

Një ditë më parë (9 nëntor) diplomati amerikan tha përmes një videomesazhi për qytetarët e Bosnjës se "Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të punojnë përmes dialogut, por nëse është e nevojshme do të bëjnë gjithçka për ta siguruar suksesin e këtij vendi".

Gjatë vizitës së tij në Bosnje dhe Hercegovinë, Escobari u takua me anëtarët e presidencës trepalëshe, Zheljko Komshiq, Shefik Xhaferoviq dhe Millorad Dodik. Ai u takua edhe me udhëheqjen e të dy dhomave të Asamblesë Parlamentare dhe përfaqësuesit e partive në pushtet dhe opozitë në nivel të Bosnje e Hercegovinës dhe dy njësive të saj.

Vizita e tij pason kërcënimet e Millorad Dodikut me largim të Republikës Sërpska nga institucionet kombëtare, siç është autoriteti i taksave, agjencia për ilaçe dhe nga ushtria.

Sipas Kushtetutës së Bosnje dhe Hercegovinës (BiH), entitetet e Republikës Sërpska dhe Federata e Bosnje dhe Hercegovinës nuk mund t'i kthejnë në mënyrë të pavarur kompetencat që i janë transferuar shtetit në periudhën e mëparshme.

Pas takimit me Dodikun më 8 nëntor, Escobar tha se biseda ka qenë produktive dhe se "është hapur mundësia që të tërhiqen vendimet e marra që kanë të bëjnë me bartjen e kompetencave në mënyrë që të vazhdojnë bisedimet për zhvillimin ekonomik".

Escobari ka thënë, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" dhënë më 5 nëntor, se njerëzit në Bosnje e dinë që komuniteti ndërkombëtar është i bashkuar për t'u siguruar që "të zbatohen përkushtimet për paqe dhe siguri të njerëzve në rajon", duke shtuar se "ne jemi të përkushtuar se nuk do të ketë luftë".

Në kuadër të vizitës së tij në Ballkanin Perëndimor, Escobari fillon më 10 nëntor një vizitë zyrtare dyditore në Mal të Zi. Ai fillimisht do të takohet me presidentin e Malit të Zi, Millo Gjukanoviq, ndërsa më pas edhe me kryeministrin Zdravko Krivokapiq dhe kryetarin e Kuvendit, Aleks Beçiq.

Ambasada e ShBA-së në Podgoricë njoftoi më herët se gjatë vizitës së tij në Mal të Zi, Escobar do të bisedojë edhe me drejtues të bizneseve për stimulimin e ekonomisë, pastaj përfaqësues të sektorit joqeveritar për luftën kundër korrupsionit si liderë të rinj politikë.

Duke folur para Komitetit të Punëve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve mbi angazhimin e administratës amerikane në Ballkanin Perëndimor më 28 tetor, Escobari tha se Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të punojnë me të gjithë partnerët malazezë që ndajnë një vizion të një shteti sovran, gjithëpërfshirës dhe demokratik që zbaton reformat për anëtarësimin evropian.

I pyetur se çfarë po bën administrata amerikane për të siguruar që qeveria aktuale të qëndrojë në rrugën drejt BE-së dhe t'i përmbushë detyrimet e saj ndaj NATO-s duke pasur parasysh ndikimin e Frontit Demokratik pro-rus, Escobari tha se më parë një delegacion malazez vizitoi Uashingtonin dhe se pala amerikane ka marrë garanci se Qeveria e Malit të Zi do t'i përmbahet anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, do të vazhdojë ta mbështesë pavarësinë e Kosovës si dhe politikën e integrimit evropian.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Rutte nga Tirana përkrah hapjen e negociatave, ngre shqetësimin për ndërhyrjet ruse në Ballkan

TIRANË, 10 NËNTOR - Kryeministri i Holandës, Mark Rutte, ka vizituar të mërkurën Shqipërinë. Në këtë shtet ai ka thënë se ky vend ka bërë përparim në vitet e fundit. "(Përparimi) ka qenë kaq i madh dhe bëri të mundur që ne të themi po", ka thënë Reutte duke iu referuar procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe mbështetjes që Holanda po ia jep Shqipërisë për t'i hapur negociatat.

Gjatë konferencës së përbashkët me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, është thënë se gjatë takimit të dy kryeministrat kanë diskutuar për procesin e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe për iniciativën "Ballkani i Hapur" (Open Balkan). "Ne kemi një marrëdhënie pune shumë pozitive. Impakti i Holandës në Shqipëri rritet vit pas viti. Kemi folur me kryeministrin për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, për luftën kundër krimit të organizuar. Përparimi i bërë në këtë bashkëpunim do të rritet si pasojë e rritjes së kapaciteteve të këtij bashkëpunimi", u shpreh Rama.

Rutte tha se e përkrah çdolloj procesi integrues të rajonit.

Kryeministri i Holandës tha se priten zgjedhjet e së dielës në Bullgari për t'u siguruar që së paku të nisin dy konferencat ndërqeveritare. "Jam shumë i lumtur që kemi qenë në gjendje që ta hedhim hapin e parë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Është e vërtetë që për të nisur zyrtarisht konferencën e parë ndërqeveritare është thelbësore që ta zgjidhim bllokimin nga ana e Bullgarisë", ka thënë Rutte.

Vendimi për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut ka ngecur në Këshillin e BE-së, pasi Bullgaria ka vendosur veto për shkak të mospajtimeve që ka me Shkupin zyrtar.

Sofja pranon gjuhën dhe identitetin maqedonas, por vetëm pas vitit 1945, para kësaj periudhë, ato, sipas saj, kanë pasur "rrënjë bullgare". Për këtë arsye disa shtete anëtare të BE-së kanë kundërshtuar që të hapen negociatat vetëm për Shqipërinë.

Edhe kryeministri shqiptar theksoi se duhet zgjidhur ngërçi i krijuar nga vetoja e Bullgarisë. "E falënderoj mikun tim Mark për kontributin personal në komunikimin me palën bullgare, e sikur të tjerët që po bëjnë përpjekjet që ta afrojnë pozicionin e Bullgarisë drejt zgjidhjes, përpara se të mblidhet Këshilli Evropian në dhjetor", ka thënë Rama.

Kryeministri holandez foli edhe për situatën në Bosnje në kohën kur ky vend është përfshirë nga kriza politike, pasi përfaqësuesit e Republikës Sërpska - entitet i banuar me shumicë serbe - nuk janë duke marrë pjesë në punën e institucioneve shtetërore. "Shqetësimi ynë është një influencë në rritje e Rusisë dhe Kinës dhe ne jemi të interesuar që perspektiva e BE-së të jetë e pranishme këtu, dhe jo perspektiva e lidhjes më të ngushtë me Rusinë, Kinën apo Turqinë", ka deklaruar Rutte.

Moshapja e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut edhe nga shumica e zyrtarëve të BE-së po shihet si e dëmshme për besueshmërinë e bllokut evropian në rajon.

Shqipëria është anëtare e NATO-s që nga viti 2009.

Asaj i është dhënë statusi i kandidatit për Bashkimin Evropian në vitin 2014 dhe prej asaj kohe është duke pritur vendimin e vendeve anëtare të BE-së për të nisur negociatat për anëtarësim. Ajo ka marrë dritën jeshile për nisjen e negociatave por, megjithatë, asnjë datë nuk është vendosur se kur do të fillojë ky proces.

Raportuesja për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Isabel Santos, tha të mërkurën se Tirana zyrtare ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për të nisur negociatat për anëtarësim në BE.

Pas një vizite treditore në Shqipëri, Santos lëshoi një deklaratë për media, ku u bëri ftesë të gjitha forcave politike në Shqipëri që ta vazhdojnë dialogun, në mënyrë që t'i ndihmohet vendit të ecë përpara në procesin e integrimeve evropiane. (rel)

Konjufca kërkon nga komisionet përshpejtim të procedimit të projektligjeve

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga shefi i kabinetit, Ilir Kërçeli dhe sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, ka zhvilluar të mërkurën një takim me kryetarët e komisioneve parlamentare, në të cilin është diskutuar lidhur me projektligjet që janë në procedurë të shqyrtimit dhe për punën e komisioneve në përgjithësi.

Konjufca e konsideroi punën e komisioneve qenësore për efikasitetin e Kuvendit, ndërsa shtoi se qëllimi i këtij takimi është njoftimi lidhur me projektligjet që janë në procedurën e shqyrtimit. "Agjenda e punës, të cilën ne e definojmë së bashku, nuk është e mundur të realizohet pa punën efektive të komisioneve parlamentare. Puna e tyre vërtet është jetike për ecurinë e Kuvendit të Kosovës, ndërsa puna e Kuvendit në përgjithësi është jo vetëm shtylla e demokracisë, por edhe shumë e rëndësishme për interesat e qytetarëve tanë", ka theksuar Konjufca. Ai ka shtuar se aktualisht në procedurë të shqyrtimit në komisione janë 31 projektligje të miratuara në shqyrtim të parë në seancë plenare.

Pasi foli për ecurinë e deritashme të shqyrtimit dhe procedimit të projektligjeve nga ana e komisioneve, kryetari Konjufca nga drejtuesit e komisioneve parlamentare kërkoi angazhim më të madh dhe dinamizim të punës për shqyrtimin dhe procedimin e projektligjeve.

Kreu i Kuvendit i kushtoi një rëndësi të veçantë nevojës për procedim sa më të shpejtë të Rregullores së re të Kuvendit nga ana e komisionit, si dhe angazhim më të madh për mbikëqyrjen e përmbushjes së veprimeve të parapara në kuadër të Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2021-2025, si dhe planit të veprimit për zbatimin e prioriteteve politike të dakorduara midis Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës për Agjendën e Reformave Evropiane.

Drejtuesit e komisioneve, nga ana e tyre, e njoftuan Konjufcën për aktivitetet dhe punën e deritashme të komisioneve që ata drejtojnë, duke theksuar edhe sfidat me të cilat përballen për arritjen e objektivave të tyre.

VAZHDOJNË REAGIMET PËR MOSFTESËN E KOSOVËS NË “SAMITIN E DEMOKRACISË”

Kosova meriton të jetë në ‘Samitin e demokracisë’

Raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovën, Viola von Cramon, e ka vlerësuar gabim të administratës amerikane mosftesën e Kosovës në “Samitin e demokracisë”, i cili organizohet më 9 dhe 10 dhjetor nga presidenti amerikan Joe Biden. Ajo ka thënë se Kosova e meriton të jetë pjesë e këtij samiti.
Për mungesën e kësaj ftese është deklaruar edhe qeveria. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se nuk ka asgjë për t’u shqetësuar se Kosova nuk është ftuar nga ShBA-ja në këtë samit

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Reagimet për mungesën e ftesës për Kosovën në “Samitin e demokracisë” nuk kanë të ndalur. Një ditë pasi organizata të ndryshme joqeveritare nga Kosova kanë kërkuar që Shtetet e Bashkuara ta shqyrtojnë thirrjen e Kosovës për të marrë pjesë në “Samitin e demokracisë”, edhe eurodeputetja Viola von Cramon, ka deklaruar që të përmirësohet ky gabim nga administrata amerikane.

Raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovën, Viola von Cramon, ka thënë se Kosova e meriton të jetë në këtë samit, i cili organizohet më 9 dhe 10 dhjetor nga presidenti amerikan Joe Biden. “Unë pajtohem që Kosova e meriton të jetë në ‘Samitin e demokracisë’, por nuk e kuptoj se cilat arsye sigurie e pengojnë pjesëmarrjen e Kosovës. Ky është, pa dyshim, një gabim i administratës Biden, i cili shpresojmë se ende mund të korrigjohet”, ka shkruar ajo në rrjetet sociale.

As senatorët amerikanë nuk i kanë të qarta kriteret mbi të cilat janë ftuar shtetet në këtë samit.

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme të Senatit amerikan, Bob Mendez, së bashku me shtatë senatorë të tjerë, i kanë dërguar letër presidentit Joe Biden duke kërkuar qartësi më të madhe dhe transparencë në lidhje me kriteret që janë përdorur për t’i ftuar shtetet në “Samitin e Demokracisë” që do të mbahet pas një muaji.

Në letrën që senatorët i kanë dërguar presidentit Biden është thënë se cilat shtete ftohen dërgohen sinjale të fuqishme mbi vlerat dhe praktikat që ShBA-ja beson se e përbëjnë demokracinë. “Së pari ne kërkojmë më shumë qartësi dhe transparencë lidhur me kriteret për selektimin e qeverive që janë ftuar të marrin pjesë në Samit. Kë ne e ftojmë dërgon një sinjal të fuqishëm lidhur me vlerat dhe praktikat që ne besojmë se e përbëjnë një demokraci. Derisa në ‘Samitin e demokracisë’ marrin pjesë edhe disa shtete që janë në vështirësi për t’i konsoliduar institucionet dhe praktikat demokratike, ne duhet të jemi të qartë se pse e kemi ftuar secilën qeveri pjesëmarrëse. Ju lutemi të na dërgoni një listë me shtetet e ftuara dhe kriteret që janë përdorur për të përcaktuar se përse secila e ka merituar ftesën”, është thënë në letrën e senatorëve.

Një ditë më parë një grup i 21 organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut u janë drejtuar me një deklaratë zyrtarëve përgjegjës në ShBA, nga të cilët kërkojnë mundësinë e rishqyrtimit të vendimit për të mos e ftuar Kosovën si pjesëmarrëse në “Samitin e demokracisë” dhe i shpalosin argumentet në mbështetje të përfshirjes. “Ne jemi të vetëdijshëm për kontekstin delikat të sigurisë në Ballkan, që prodhon ndarje të thella etnike dhe shpesh paqëndrueshmëri. Megjithatë, duke pasur parasysh përparimin e vazhdueshëm që Kosova ka bërë gjatë viteve për të ndërtuar demokraci, por edhe raportet e posaçme në mes të popullit të Kosovës dhe të Shteteve të Bashkuara, ne besojmë se Kosova meriton të jetë pjesë e kësaj iniciative strategjike dhe do të përfitonte nga e njëjta”, është thënë në këtë letër.

Kryetari i bordit të platformës jofitimprurëse “Sbunker”, Agon Maliqi, ka treguar se në këtë letër janë cekur argumentet e kërkesës së tyre. “Një grup i 21 organizatave të shoqërisë civile që merremi me çështjet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut u jemi drejtuar me një deklaratë zyrtarëve përgjegjës në ShBA, ku e kërkojmë mundësinë e rishqyrtimit të vendimit për të mos e ftuar Kosovën si pjesëmarrëse në ‘Samitin e demokracisë’ dhe i shpalosim argumentet në mbështetje të përfshirjes”, ka shkruar Maliqi në profilin e vet në “Facebook”.

Për qeverinë nuk është shqetësuese mungesa e ftesës

Për mosftesën e Kosovës në këtë samit është deklaruar të mërkurën edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Gjatë një tubimi elektoral në Podujevë, Kurti ka thënë se nuk ka asgjë për t’u shqetësuar pse Kosova nuk është ftuar nga ShBA-të në këtë samit. “Nuk ka asgjë për t’u shqetësuar. E kemi shpjeguar edhe më herët dhe këtë e ka konfirmuar shumë thjesht edhe Ambasada Amerikane”, ka thënë Kurti.

Ambasada Amerikane në Prishtinë ka thënë për mediat lokale në Kosovë se jo të gjithë partnerët kanë mundur të akomodohen në këtë iniciativë. “Qëllimi ka qenë që të bashkohet një grup rajonal dhe socio-ekonomik i vendeve dhe juridiksioneve, duke përfshirë demokracitë më të zhvilluara dhe ato në zhvillim me diversitet në popullsi, demografi dhe vendndodhje”, është thënë në përgjigjen e ambasadës.

Ndër të tjera, ambasada ka thënë se ShBA-ja vazhdon të jetë e përkushtuar për të punuar me Kosovën në forumet e tjera për të avancuar në forcim të demokracisë.

Mungesa e kësaj ftese për Kosovën ka nxitur reagime të shumta në Kosovë.

Njohësit e rrethanave politike mosftesën e Kosovës e kanë vlerësuar si shuplakë të ShBA-së dhënë Kosovës. Për këtë ata e

→

MAShTI, me bashkëpunim akademik me ShBA-në, këtë vit do të ketë rritje të numrit të përfituesve

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci dhe i ngarkuari me punë në Ambasadën Amerikane në Kosovë, Nicholas J. Giacobbe, kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshjen e mirëkuptimit për Programin Fullbright të Shkëmbimit Akademik ShBA - Kosovë.

Ministrja e MAShTI-t, Arbërie Nagavci, ka thënë se këtë vit do të ketë shtim të numrit të përfituesve në këtë program. Ajo ka thënë se rritja e fondeve për programin u mundëson që bashkëpunimi akademik të zgjerohet. "Shumë nga projektet që kemi mbështetur përmes bashkëpunimit janë fokusuar në shkëmbimin akademik në mes të institucioneve arsimore dhe kërkimore në ShBA dhe Republikën e Kosovës për studentë, mësimdhënës, profesorë, hulumtues, ekspertë të arsimit. Me anë të këtij bashkëpunimi studentëve tanë ua kemi hapur rrugën për studime në institucione prestigjioze amerikane, në programe me interes për zhvillimin e vendit, stafit akademik i mundësojmë rrjetëzim dhe hulumtim në bashkëpunim me institucionet hulumtuese amerikane që në planin afatgjatë kontribuon në ngritjen e performancës dhe zhvillimit edhe të hulumtimit në vendin tonë", ka thënë Nagavci. Ai ka thënë se kanë arritur ta themelojnë bordin e shkëmbimit arsimor ShBA - Kosovë dhe se Kosova është e para që ka arritur themelimin e një bordi të tillë.

Nicholas J. Giacobbe u shpreh i lumtur me realizimin e këtij programi, duke theksuar se mbi 400 mijë përfitues marrin pjesë në këtë program nga e gjithë bota.

→

kanë fajësuar Qeverinë e Kosovës. Analisti politik Ilir Ibrahimi ka vlerësuar se mungesa e ftesës për Kosovën është shqetësuese. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se qeveria urgjentisht duhet të ndërrojë kurs, sepse raportet me ShBA-në janë lënduar. "Deri tani kemi dëgjuar apo parë mospajtime me zë të ulët nga administrata Biden ndaj qasjes së Qeverisë së Kosovës. Lënia anash e Kosovës, si një nga 4-5 vendet evropiane që nuk ftohen në 'Samitin e demokracisë 2021', është britmë. Presidentja brenda pak javësh ishte dy herë në ShBA dhe nuk e takoi asnjë zyrtar të administratës. Kryeministri, i cili kishte deklaruar se do ta vizitojë ShBA-në në nëntor, e anuloi vizitën për shkak se, sipas disa burimeve, nuk arriti të sigurojë ndonjë takim me administratën", ka shkruar ai, duke shtuar se askush nuk e ka luksin që t'i vë në pikëpyetje interesat strategjike të Kosovës me ShBA-në. "Qeveria e Kosovës urgjentisht duhet të ndërrojë kurs dhe t'i kthehet ndërtimit tanimë të lënduar të marrëdhënieve me aleatin kryesor. Askush nuk mund t'ia japë vetes luksin që për bindje ideologjike të vë në pikëpyetje interesa strategjike të vendit", ka shkruar Ibrahimi.

Samiti për Demokraci do të ketë tri tema kyçe: Mbrojtjen kundër autoritarizmit, adresimin dhe luftimin e korrupsionit dhe avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut. Pas takimit të parë dhe konsultimeve me të, Bideni do t'i ftojë liderët botërorë sërish që të diskutojnë rreth përparimit të bërë.

Policia arreston tre persona të dyshuar për falsifikim parash

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, konkretisht Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Gjakovë, ka realizuar të mërkurën një urdhërkontroll në tri lokacione.

Gjatë realizimit të këtij urdhërkontrolli janë arrestuar tre të dyshuar të cilët me veprimet e tyre dyshohet se kanë kryer veprën penale "Falsifikim i parasë". "Personat e dyshuar, në bashkëkryerje, me datë 20.10.2021 në komunën e Malishevës kanë lëshuar në qarkullim dollarë amerikanë të falsifikuar në një këmbimore. Rasti është iniciuar dhe raportuar në Stacionin e Malishevës ku më pastaj është proceduar për trajtim në NJRHKEK - Gjakovë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Hetuesit e Njësisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Gjakovë, pas një mori veprimesh hetimore dhe operative, në koordinim të ngushtë me prokurorin kompetent dhe me NJRHKEK-në në Prizren, kanë arritur të sigurojnë identitetin e të dyshuarve, lokacionet e banimit të të dyshuarve dhe dëshmi të mjaftueshme për ta. "Të dyshuarit H. Sh. (1987), L. Q. (2003) dhe H. L. kanë vënë në qarkullim dollarë amerikanë të falsifikuar dhe me këto veprime kanë krijuar dyshimin e arsyeshëm se kanë kryer veprën penale 'Falsifikim i parasë' nga neni 296 i KRPK-së. Personat e dyshuar janë arrestuar dhe me aktvendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje për 48 orë, ndërsa rasti vazhdon të hetohet nga NJRHKEK Gjakovë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Mbahet punëtoria për qeverisjen e hapur lokale, integritetin politik dhe etikën publike

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Me qëllim që t'i pasurojë njohuritë e shefave dhe zyrtarëve komunalë për prokurim mbi standardet, mekanizmat dhe praktikat e mira evropiane, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), në partneritet me Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi), ka organizuar punëtori mbi qeverisjen e hapur lokale, integritetin politik dhe etikën publike. Takimin dhe të pranishmit i kanë përshëndetur Sazan Ibrahimi, drejtor ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Gëzim Plakolli, zyrtar i lartë i Projektit në Këshillin e Evropës.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës në bashkëpunim të ngushtë me Asociacionin e Komunave të Kosovës aktualisht është duke zbatuar projektin "Promovimi i demokracisë lokale" (2020-2021), i cili synon ta përmirësojë vetëqeverisjen lokale dhe cilësinë e demokracisë lokale, duke nxitur një dialog shumë nivelesh dhe duke forcuar kapacitetet e autoriteteve lokale dhe përfaqësuesve të zgjedhur për të vepruar si nxitës të ndryshimit.

Projekti adreson elementet kryesore të qeverisjes së mirë, përfshirë mënyrat për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, avancuar etikën publike dhe nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve si një mjet për ta përforcuar llogaridhënien e administratës publike lokale.

Kosova dhe Maqedonia e Veriut zotohen për bashkëpunim në fushën e sigurisë

SHKUP, 10 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, në kuadër të konferencës vjetore të Kartës së Adriatikut - ShBA, ka realizuar takim me zëvendësministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, Bashkim Hasani. "Bashkëpunimi fqinjësor me Maqedoninë Veriore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, me rëndësi të madhe edhe për rajonin në përgjithësi", ka thënë Mehaj. Përveç të tjerash, Mehaj ka thënë se me zëvendësministrin Hasani u pajtuan që bashkëpunimi ndërministror është në nivel të shkëlqyeshëm dhe se Karta e Adriatikut do të jetë përmbajtjesore me anëtarësimin edhe të Kosovës me statusin e plotë, si dhe kontributin e saj të dëshmuar tani dhe në të ardhmen, në sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Lladrovci, bashkë me Endrit Thaçin, nderojnë heronjtë në sheshin 'Fehmi Lladrovci"

DRENAS, 10 NËNTOR - Kryetari i komunës së Drenasit, njëherësh kandidat edhe për një mandat qeverisës, Ramiz Lladrovci, të mërkurën kishte mysafir të veçantë Endrit Thaçin, djalin e ish-presidentit Hashim Thaçi. Në sheshin "Fehmi Lladrovci", kryetari Lladrovci së bashku me Endritin dhe me shefin e grupit parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri dhe Ismail Sylën, kanë vendosur buqeta me lule pranë shtatoreve të heronjve të kombit. "Nderim i përjetshëm sakrificës dhe heroizmit për liri", ka shkruar Lladroci në llogarinë e vet në "Facebook".

Arrin varianti ‘Delta Plus’ në Kosovë, prej 70 mostrave të testuara, 12 pozitive

Prej shtatëdhjetë mostrave të dërguara për testim, të cilat kanë rezultuar pozitive me koronavirus në Kosovë, të dërguara për sekuencionim përmes projektit të ECDC në laboratorët Eurofin në Gjermani, sekuencionimi është bërë në 59 raste, prej të cilave në 12 raste (20.33 për qind) është detektuar varianti ‘Delta Plus’ dhe në 47 raste (79,66 për qind) është detektuar varianti ‘Delta’

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 10 nëntor - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka informuar se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka pranuar rezultatet për mostrat e dërguara në dërgesën e pestë për sekuencionim përmes projektit ECDC në Eurofin Genomics në Gjermani.

Prej shtatëdhjetë mostrave të dërguara për testim, të cilat kanë rezultuar pozitive me koronavirus në Kosovë, të dërguara për sekuencionim përmes projektit të ECDC në laboratorët Eurofin në Gjermani, sekuencionimi është bërë në 59 raste, prej të cilave në 12 raste (20.33 për qind) është detektuar varianti ‘Delta Plus’ dhe në 47 raste (79,66 për qind) është detektuar varianti ‘Delta’.

IKShPK-ja planifikon që më 15 nëntor t’i dërgojë mostrat e tjera pozitive me SARS-CoV-2 të mbledhura gjatë dy javëve të fundit, përmes të njëjtit projekt, me qëllim të mbikëqyrjes virologjike të varianteve të SARS-CoV-2 në qarkullim në Kosovë.

“Situata me Covid-19 në Kosovë, sipas analizës së situatës epidemiologjike me Covid-19, paraqet rënie të numrit të rasteve për 19,11 për qind krahasuar me dy javët e fundit”, ka njoftuar MSh-ja.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, ekipet e IKShPK-së po hulumtojnë dhe gjurmojnë pandërprerë të gjitha burimet e mundshme për ta parandaluar përhapjen e mëtutjeshme të rasteve, detektimin e hershëm të rasteve dhe implikimet e mundshme në shëndetin e njeriut për variantin e ri ‘Delta Plus’. “Pasi që janë detektuar 12 raste SARS CoV-2 varianti AY.4-like ‘Delta Plus’ në Kosovë (20,33 për qind), edhe pse varianti ‘Delta’ ende është dominues (79,66 për qind), ekziston rreziku i përhapjes së shpejtë të variantit të ri ‘Delta Plus’. Duke pasur parasysh numrin e lartë të personave aktivë që mund të bartin infeksionin dhe të panjohurat për shpërndarjen e shpejtë të Covid-19, Ministria e Shëndetësisë u bënë thirrje të gjithëve që t’i zbatojnë vendimet e fundit të qeverisë dhe të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i masave me një dinamikë të shtuar të kontrollit nga ana e inspektorateve dhe Policisë së Kosovës për të pasur efekt në uljen e lakores epidemiologjike dhe në uljen e numrit të vdekjeve”, ka njoftuar kjo ministri.

Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë u bënë thirrje qytetarëve që ende nuk janë vaksinuar ta bëjnë një gjë të tillë sa më parë me qëllim të mbrojtjes nga secili variant i SARS-COV-2 dhe arritjen sa më të shpejtë të imunitetit me vaksinën kundër Covid-19 duke u vaksinuar plotësisht.

Në 24 orët e fundit, 14 raste të reja me Covid në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 1 696 testimeve, 14 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të mërkurën janë shëruar 17 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 483. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 444.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 2 413 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 587 467 doza të vaksinës. Deri më sot 744 671 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

KQZ-ja vendos të rinumërohen edhe 155 vendvotime për kuvende komunale

Prishtinë, 10 nëntor - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e mbajtur të mërkurën ka miratuar rekomandimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për rinumërimin edhe të disa kutive që u takojnë zgjedhjeve për kuvende komunale. Kështu ka vendosur PZAP i cili ka miratuar ankesat e një numri të caktuar të kandidatëve për kuvende të ndryshme komunale. “KQZ-ja më 9 dhe 10 nëntor ka pranuar disa vendime të tjera nga PZAP-i. Në bazë të këtyre vendimeve kërkohet nga KQZ-ja që të bëhet rinumërimi i votave të kandidatëve në një numër të caktuar të vendvotimeve. Numri i vendvotimeve të rregullta që do të rinumërohen është rreth 155 vendvotime të rregullta që u takojnë komunave të ndryshme,

PZAP-i ka vendosur edhe për rinumërimin e dhjetë kutive të votave me postë. Rekomandohet që të bëhet rinumërimi i plotë i këtyre”, ka thënë Burim Ahmetaj, kryeshef ekzekutiv i sekretariatit të KQZ-së.

Ai ka treguar edhe numrin e përgjithshëm të vendvotimeve që do të rinumërohen sipas vendimit të PZAP-it, duke përshirë këtu ato të ditës së hënë dhe ato për të cilat u vendos të mërkurën. “Me datën 8 janë 437 vendvotime të rregullta përfshirë edhe votat me kusht dhe postë që 467 kuti të votimit që duhet të rinumërohen sipas vendimeve të ardhura më 8 nëntor. Me datën 9 nëntor kanë ardhur 138 vendime për rinumërim të vendvotimeve të rregullta të komunave të ndryshme dhe 11 kuti të votimit të votave me postë. Me datën 10 nëntor janë gjithsejtë 14 vendvotime që në total bëjnë 589 vendvotime të rregullta, duke përfshirë edhe 23 kuti të votave me postë dhe 18 kuti të votave në kusht, gjithsejtë 630 kuti, duke përkthyer në përqindje 23,78 për qind e kutive që duhet të rinumërohen sipas vendimit të PZAP-it”, ka thënë Burim Ahmetaj.

Këto vendvotime u takojnë komunave të ndryshme të Kosovës: Drenas, Viti, Istog, Shtime, Vushtrri, Klinë, Prishtinë, Pejë, Lipjan, Prizren, Gjilan, Malishevë, Deçan, Skenderaj, Kaçanik dhe Fushë-Kosovë.

Kurti premton 100 milionë euro investime në bujqësi

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se sektorit të bujqësisë i kanë ndarë 40 milionë euro obligime, ndërsa buxheti është rritur në 70 milionë euro që, përfshirë edhe donacionet në bujqësi në vitin 2022, do të investohen rreth 100 milionë euro

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar të mërkurën mbledhjen e radhës në të cilën ka miratuar pesë projektligje dhe vendime të tjera të përgjegjësive të saj kushtetuese dhe ligjore.

Në fjalën e hapjes kryeministri Albin Kurti është fokusuar për angazhimin e qeverisë për të siguruar rritje dhe mbështetje të fuqishme të sektorit të bujqësisë në vend. "Nëpërmjet politikave afatgjata dhe shtimit të buxhetit, Qeveria e Republikës së Kosovës është duke u siguruar, që ta përkrahë sektorin e bujqësisë, si është më së miri e më sigurt, duke e rritur përkrahjen për fermerët tanë. Kjo përkrahje e madhe do të gjejë mbështetje dhe siguri në legjislacionin të cilin ne po e konsolidojmë, duke filluar me Projektligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, të cilin e kemi në rend të ditës. Kemi filluar nga adresimi i obligimeve të trashëguara ndaj fermerëve, që ishin rreth 40 milionë euro dhe e kemi rritur buxhetin për bujqësi", ka thënë Kurti, duke theksuar se dy javë më parë me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, kanë lansuar masat për investimin në shtim të prodhimtarisë dhe zgjerim të kapaciteteve prodhuese. "Krahas buxhetit të ri e të rritur, me zero obligime financiare karshi fermerëve, Kosova vitin e ri e fillon me strategji shtatëvjeçare për bujqësi dhe zhvillim rural, si dhe strategji dhjetëvjeçare për pylltari. Pra, buxhet më të madh dhe orientim afatgjatë, me kritere të qarta e transparente për të gjithë. Me buxhetin e ri për vitin 2022 do të realizohet përkrahja më e madhe ndonjëherë, me 70 milionë euro. E bashkë me përkrahjen nga Komisioni Evropian dhe donatorë të tjerë, në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, në total do të investohen afërsisht 100 milionë euro", ka deklaruar Kurti.

Kryeministri ka thënë se nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë aplikuar në Programin për Bujqësi Globale dhe Siguri Ushqimore (GAFSP) për grantin prej 20 milionë eurosh, mbështetje për fermerët e vegjël, të cilët janë ndihmuar pak deri më tani. "Pra, buxhet mbi 100 milionë, strategji afatgjatë, lehtësime dhe shërbime të subvencionuara, treg dhe transparencë. Do t'i kemi së paku edhe 10 milionë euro për rezerva shtetërore, që mund të mbushen me prodhime vendore", ka deklaruar Kurti.

Promovimi i ndërmarrësisë në Kosovë, bizneset kërkojnë që shkollat të përgatitin kuadro të reja

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ngjarja e radhës në kuadër të javës globale të ndërrmarrësisë, e organizuar nga Oda Amerikane, kishte për temë diskutimi përfshirjen e arsimit dhe shkollave profesionale në mënyrë që kjo të përkthehet në përgatitjen e kuadrove të reja dhe të shërbejë si ndihmë për ndërmarrësit e rinj.

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se kjo temë është shumë e rëndësishme duke ditur se Java Globale e Ndërrmarrësisë synon t'i frymëzojë gratë dhe burrat në fushën e ndërrmarrësisë. Më tutje, u shpreh se gjatë kësaj jave shkëmbehen storiet e suksesit dhe sfidat e ndërrmarrësve të rinj, duke ftuar kështu të gjithë aktorët relevantë që së bashku t'i mbështetin këta ndërmarrës.

Ministrja Nagavci ka theksuar se edukimi në ndërmarrësi sjell përfitime të shumta dhe për këtë arsye janë të rëndësishme aftësitë e mësuara nga nxënësit përmes kurrikulës që të sjellin dobi në karrierën e tyre dhe të jenë të inkurajuar të përcaktojnë karrierën e tyre.

Andina Vllahiu-Kelmendi, menaxhere e politikave dhe komunikimit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, u shpreh se Java Globale e Ndërrmarrësisë është mundësi e jashtëzakonshme që të diskutohet për elementet e ekosistemit të ndërrmarrësisë, e ku edukimi është element i rëndësishëm, prandaj Oda Ekonomike Amerikane beson se nëpërmjet edukimit, ndërrmarrësit e rinj pajisen me njohuri për sigurimin e burimeve, por edhe rritjen e shkathtësive inovative dhe kreative.

Diellza Gashi, ligjëruese e lëndëve të menaxhmentit nga Universiteti Amerikan në Kosovë, përmendi revolucionin në arsim sa i përket fushës së ndërrmarrësisë, ndërrimin e mendësisë së edukimit tradicional nëpër shkolla dhe se të rinjtë të shihen si kompetentë për zgjidhjen e problemeve. Ajo ka theksuar rëndësinë e fillimit të hershëm në fushën e ndërrmarrësisë dhe i ka inkurajuar të rinjtë të jenë sa më shumë të pranishëm në aktivitete dhe trajnime të ndryshme.

Menaxherja e Programit ASSET, Qendra e Edukimit të Kosovës, Luljeta Demjaha Belegu, dha më shumë informacione rreth projektit të financuar nga USAID-i, ku u shpreh se fokusi i këtij projekti ishte ta ndihmojë reformën e arsimit, ku të gjithë mësimdhënësit janë të trajnuar. Nxënësit kanë përfituar njohuri të ndryshme rreth planit të bizneseve se si analizohet tregu, e në fund ata nxënës kanë dalë me firmë virtuale të menduar nga vetë ata.

Alejtin Berisha nga Kolegji "Universum", njëherësh edhe moderator i kësaj ngjarjeje, përmendi një problematikë me të cilën po ballafaqohen institucionet arsimore, siç është ajo e shkollave profesionale, e cila nuk gjeneron të hyra dhe se fokusi i ndërrmarrësisë qëndron te fusha e teknologjisë dhe fushave natyrore. Më tutje, ai shtoi se shkollat duhet të kenë pavarësi më të madhe.

Koncepti i bukurisë në lirikën erotike të Migjenit

Nga: Alisa VELAJ



Në trashëgiminë e paktë dhe madhështore poetike të Migjenit, me vetëm 42 poezi, një vend edhe më të paktë zë lirika e mirëfilltë erotike, e cila përbëhet nga katër poezi: *Dy buzë*, *Z.B.*, *Ndeshja* dhe *Një natë*.[1] **Bukuria e erosit merr trajtat e bukurisë që vret shpirtrat dhe të bukurisë që i ringjall këta shpirtra.** Uni lirik i këndon dashurisë në të tri dimensionet e saj: shpirtërore, përsiatëse dramatike dhe epshore. Të tri dimensionet shkrihen më njëri-tjetrin në një harmoni fatale në lirikat *Dy buzë* dhe *Ndeshja,* ndërsa përftojnë një esencë lumturie të hijshme (*dashni të hijshme*) në vargjet e këngëve *Z. B.* dhe *Ndeshja.* Bukuria që vret gëzimin e jetës prej një *gruaje stërzane* në vargjet e lirikës *Dy buzë* krijon disa lloje asosacionesh poetike, që marrin hov mes kohëve faktike ***kur më vrau bukuria*** dhe ***kur më zu dashunia.*** Drama zë fill te bukuria e dashurisë, bash në kohën kur dashuria pushton ndjesitë e trupit e shpirtit, por bukuria në vetvete nuk përshkruhet në këtë lirikë. Ajo vetëm sa jep një imazh të mjegullt hyjnor dhe çka tmerron janë pasojat që vijnë prej fatalitetit të saj (*bukuri fatale*). Kohët faktike ngjizen përmes një shkallëzimi ngjitës, duke sinkronizuar kështu fuqinë rritëse të bukurisë vrastare, ku shenjuesit e tekstit poetik renditen si vijon: së pari, bukuria që vret si habitati mëmë i togfjalëshave*bukuri fatale, një pjesë zemre ma nxorne, gëzimin ma vodhne* dhe së dyti, zafillja e dashurisë si habitat i togfjalëshave *dy buzë të kuqe, dy dëshira të flakta, dy buzë si të përgjakta, që afshin ma thithën, andjet m'i trazuan, zemrën ma tërbuen, trurin ma helmuen.* Erotikja ngjizet përmes ndryshimeve në nuancat e ngjyrës së kuqe, si treguese e drejtpërdrejtë e epshit dhe pasionit në tekstin poetik. Metafora të kuqe, të flakta dhe të përgjakta sinkronizohen në mënyrë absolute me afshin/andjet, zemrën dhe trurin. Përftojmë kështu të kuqen afshndjellëse, trazuese, të kuqen e përflakur e tërbuese dhe të kuqen e përgjakur helmuese. Shtegtimi i ndjesive prej trazimit deri në vdekje, e mek gëzimin e jetës dhe bukuria fatale kryen një vrasje të ngadaltë të qenies në plotninë e saj.

Në lirikën *Ndeshja* bukuria që vret nuk vjen prej sferave të dashurisë, por lind në ndeshjen mes shpirtit të dashurisë dhe të tjerëve jashtë saj, në atë botën vrastare, të qenieve jo të lira e përqeshëse *që shkuen të kënaqun e tu' u gëzue – pse panë mfshehsinat intime të kësaj jetesës sonë.* Një dramë e thellë, ku fajtorët e pafaj vuajnë e dënohen për pafajësinë e dëlirësinë e tyre(*vuejshim me zemër të ndrydhun si dy fëmijë*). Nëse në lirikën e parë kemi një shpërthim të ndjesive erotike e shpirtërore, që sjell helmimin e poetit, në këtë lirikë kemi ndjesitë që vijnë të ndrydhura, dhe është pikërisht kjo ndrydhje e bukurisë, ajo çka e shndërron gëzimin në kob (*në ditn e fatkobit tem/ në ditn e fatkobit tonë*). **Në atmosferën e poezisë *Dy buzë* kemi një flijim të vetëm, ndërsa në atmosferën e elegjisë *Ndeshja,* fataliteti i moskuptimit të bukurisë së dashurisë prej të tjerëve, arrin pikën kulmore me flijimin e dy të dashuruarve (*e ndjejshe veten se dhe unë jam fli/ të një ndjesi/ si ti*).** Flijimi apo fatkobi i parë është bukuria që vret e një stërzane plot epsh e flakë gllabëronjëse, ndërsa fatkobi tjetër bukurinë e ngjallur e ka shpënë drejt një turre ku djeg joliria e shpirtrave që s'e kanë njohur kurrë bukurinë. Migjeni këndon e ofshan për *mfshehsinat intime,* të cilat jo vetëm mbeten të pakuptuara nga vrasësit e bukurive, por edhe të pakënduara ende me kaq sharm e finesë nga poetët e kohës së tij. Në këtë kontekst, Millosh Gjergj Nikolla është një prijatar i erotikes në lirikën shqiptare. Po ashtu, kjo bukuri që ka pranë vdekjen, apo vdekja që vjen prej bukurisë është një koncept që në letërsinë tonë vjen për herë të parë prej Migjenit. Bukuria që vret tjetrin përballë saj është një koncept i ardhur prej skicës së tij të mrekullueshme "Bukuria që vret", por që në lirikën e tij erotike rifunksionalizohet në funksion të kontekseve kryekëput të ndryshme. E përbashkëta qëndron në "faktin" se ajo që vritet është drita e shpirtit.

Bukuria, që ringjall e përtërin shpirtra, ngjizet nga*një dashni e lume* nëlirikën *Z. B.*, e cila vjen si një ode plot nota gëzimi, plot qiej e sy të lumturuar. Një lloj atmosfere ku e kuqja e pasionit erotik nuk i prek kufijtë e epshit, tek vjen *me kuqlim e tisa purpuer* dhe me ngjyrat feksëse lindur nëpër *gëzime të pamatna.* Lexuesi i kësaj lirike ndjen frymimin e bukurisë së kulluar e parajsore. **Një pamje e bukurisë së dashurisë dhe e dashurisë së bukurisë, si në vargjet e "Këngës së Këngëve" në Shkrimet e Shenjta, ku erotikja shpërfaqet sa e shenjtëruar, po aq edhe e përmallshme thellësive të saj të tejpashme.** Në poezinë kushtuar zonushës Bojka, më shumë se gjithçka, poeti ka mall për bukurinë e thellësive më të dëlira të shpirtit, atje ku dashuria ndeshet me lumturinë e pacak. Figura e gruas qëndron në kufirin mes tokësores dhe qiellores edhe në poezinë *Një natë,* ku uni lirik shfaqet i mëdyshur, nëse ajo që *zbriti nga sfera të panjoftuna* është *grue a hyjneshë*. Hyjnorja në këtë lirikë ka të bëjë vetëm me prekjen e dimensionit të lumturisë prej shpirtit të dashuruar, ndërsa përshkrimi i bukurisë së gruas dhe përshkrimi i ndjesive të subjektit të dashuruar janë tejet tokësore dhe epshndjellëse.

Dhe njëmend! At natë vallëzuen ndjesit e jona
më një valle dëfryese, pa marrun frymë…

Dashuria epshore dhe shpirtërore krijojnë harmoninë e tyre më të mrekullueshme në këtë akord plot pasion, ku nata përndritet nga bukuria, ku dashuria është e hijshme dhe ku qeniet shijojnë *frytin e ambël të marrëveshjes*. Bukuria e harmonisë, mes ndjenjave të shpirtit dhe atyre epshndjellëse, mbetet padyshim një risi e Migjeni dhe e Lasgush Poradecit në lirikën erotike shqiptare. **Po nëse Poradeci i mëshon më së shumti erosit në vetvete apo bukurisë fizike si shtangie e unit lirik, Migjeni e sheh erotiken në harmoni të plotë me dashurinë shpirtërore**. Erosi migjenian vjen si pasojë e një pushtimi absolut të shpirtit prej ndjenjave më hyjnore të dashurisë. Migjeni ndjen epshin fill pasi trand shpirtin, ndërsa Lasgushi hyjnizon pikë së pari bukurinë fizike, duke mbetur "peng" i këtij hyjnizimi.

/exlibris.al

POEZITË E MIGJENIT

DY BUZË

Dy buzë të kuqe,
dy dëshira të flakta,
që afshin ma thithën,
gëzimin ma fikën,
si fantazma ikën
ndër do bota të larta…
Dy buzë si të përgjakta,
dy dëshira të flakta,
që afshin ma thithën
në buzë kur m'u njitën –
andjet m'i trazuan,
zemrën ma tërbuen,
trurin ma helmuen
e në fund u mërguen…
Dy buzë të kuqe,
bukuri fatale,
të një gruaje stërzane
një pranverë të tanë më morne,
një pjesë zemre ma nxorne,
dhe gëzimin ma vodhne…
Ato dy buzë të kuqe
dhe dy lotë të mia
qenë shenjat e dhimbjes
kur më vrau bukuria,
kur më zu dashunia
e më dogji rinia.

***

Z.B.

Buzmramja u dridhte ndër afshet e mbramë
të diellit përndimuer
me kuqlim e tisa purpuer,
me kaltrina të kullueta në qiellë e në sy tand…
ku në fund u pasqyronte një dashni e lume
si vegimet e fatbardhsis në lima,
mbi të cilin tërthuer fluturon një pëllumb
dhe gëzime të pamatna gugon pa pra.
Zojushë, q'at buzmramje,
unë andrroj me andje
dhe me një dashni të pastër
ata dy sy tuej të kaltër,
që m'u falne letë
me një shikim diskret.

***

NDESHJA

O grue që të ndesha në ditn e fatkobit tem,
kur prirja njellte e syt shikojshin zi
e ndjejshe veten se dhe unë jam fli
të një ndjesi
si ti.
O grue q'u ndeshme ditn e fatkobit tonë
zemër për zemër edhe ball për ball
e ndjesitë m'u shprehën me mall
më një vall':
sa hall…
Dhe kështu në rrugë të madhe e shitme zemrën tonë
njerezve që vetëm një të përqeshun dhanë për të
e shkuen të kënaqun e tu' u gëzue – pse
panë mfshehsinat intime të kësaj jetesës sonë.
E na, dhe një dhimbë të sinqertë tue ndijë,
vuejshim me zemër të ndrydhun si dy fëmijë
të humbun ndër vise të hueja natën, vonë,
o grue q'u ndeshme ditn e fatkobit tonë.

***

NJË NATË

Grue a hyjneshë, e mbështjellun n'errsi të natës,
zbriti nga sfera të panjoftuna ndër odat e mia
dhe u shtrue një fllad, një e kandshme ndjesi,
një heshtje parathanse zemrën don të ma përpijë.
Vetëm që ora këndon kangën e thjeshtë të natës
jo – jo' dhe diku larg dëgjohen tingujt e kangës.
Grue a hyjneshë m'erdhi nga gjini i errsinës…
Që frymën ia ndjej dhe zemrën që rreh prej fellsinës.
Buzët e njoma të saj,
Syt e zez e të mdhaj
me harmoni vijash të bindshme
premtojnë një dashni të hijshme
(ashtu dhe akordi i heshtjes
frytin e ambël të marrëveshjes).
Dhe njëmend! At natë vallëzuen ndjesit e jona
më një valle dëfryese, pa marrun frymë…



Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova humbet miqësoren ndaj Jordanisë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pësuar humbje në stadiumin "Fadil Vokrri" në miqësoren kundër Jordanisë (0-2). Pavarësisht largimit të përzgjedhësit Bernard Challandes, futbollistët "dardanë" nuk o këndellen as në miqësoren ndaj një kundërshtar jo edhe aq të fortë. Kosova në këtë ndeshje u drejtua nga përzgjedhësi i përkohshëm Primozh Gliha. Në minutën e 18-të, Faisal shënoi gol nga largësia i ndihmuar edhe nga një devijim i mbrojtësit Betim Fazlij. Kosova është mundur të rikthehet në lojë, por disa raste nuk u shfrytëzuan dhe pjesa e parë përfundoi me rezultat 0-1. Në pjesën e dytë, Kosova pati iniciativën dhe regjisori shumë raste shënimi, por Vedat Muriqi, Valon Berisha e Edon Zhegrova nuk i konkretizuan. Muriqi madje e goditi edhe shtyllën, por assesi futbollistët "dardanë" nuk patën mundësi të dërgojnë topin në rrjetën e portierit kundërshtar. Në anën tjetër, Dardour realizoi edhe golin e dytë pesë minuta para përfundimit të kohës së rregullt. Në minutat shtesë, Al-Rawabdeh u ndëshkua me karton të kuq. "Jam i zhgënjyer me rezultatin sepse kishim shumë raste dhe nuk shënuam. Krijuam shumë raste, por nuk patëm fat, por ndoshta do ta kemi në ndeshjen e ardhshme. Në futboll kur krijon raste, do të thotë që kemi luajtur mirë. Por kur filloni të shënoni gola atëherë duket më e dukshme. Do të flas me ekipin për të gjetur një zgjidhje. Do të shkojmë të luajmë në Greqi me të njëjtin mentalitet", ka thënë Primoz Gliha, trajner i Kosovës. Kosova të dielën e zhvillon ndeshjen e fundit kualifikuese për Kupën e Botës kundër Greqisë në Athinë.

'Dardanët' U17 mposhten në miqësore nga Turqia

Përfaqësuesja e Kosovës U17 e ka zhvilluar ndeshjen e parë miqësore me Kombëtaren e Turqisë U18, në kuadër të përgatitjeve për Elite Round, në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2022. "Dardanët" U17 pësuan humbje pavarësisht paraqitjes së mirë që patën, me rezultat 1:0. Të përzgjedhurit e Arsim Abazit nuk arritën të konkretizojnë rastet që kishin, veçmas në pjesën e dytë kur u liruan nga presioni dhe shfaqën lojë dukshëm më të mirë. Megjithatë, mysafirët të cilët ishin një gjeneratë më e madhe, në periudhën kur "Dardanët" bënin përpjekje për të gjetur rrugën e golit, arritën të zhbllokojnë shifrat pas një korneri të shkurtër në minutën e 80-të, kur realizoi Yasar Kavas.

Morina: Do të luajmë për fitore kundër Norvegjisë dhe Danimarkës

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Basketbollistët e Kosovës kanë vizituar Qendrën Nacionale të Basketbollit, duke u dhënë motiv basketbollistëve të stërviten dhe t'i realizojnë ëndrrat e tyre. Qendra Gëzim Morina ka mbetur shumë i kënaqur me punën që po bëhet në këtë qendër. "Mendoj se është një gjë shumë e rëndësishme dhe për këtë e përgëzoj Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe të gjithë themeluesit e projektit. Është shumë e rëndësishme sepse stërvitjet janë elementare për një lojtar të jetë i suksesshëm. Këtë mundësi nuk e kemi pasur ne derisa kam shkuar në Slloveni. Është e mirë se stërvitjet dy herë në ditë janë baza për të qenë i suksesshëm. Mesa kuptova, stërviten dy herë në ditë dhe kanë trajnerët më të mirë (Arben Krasniqi, Driton Obërtinca dhe Valentin Spaqi), prej të cilëve çdo ditë mund të mësojnë dhe është një nga projektet më të rëndësishme nga FBK", është shprehur Morina për faqen zyrtare të FBK-së.
Basketbollisti i Golden Eagle Yllit ka folur për dy ndeshjet e Kosovës, ndaj Norvegjisë më 25 nëntor dhe Danimarkës në Prishtinë më 28 nëntor. "Jam

shumë i lumtur sepse në dy herët e fundit (grumbullimet) nuk kam mundur të jem pjesë e përfaqësueses. Norvegjia dhe Danimarka janë ekipe të mira. Fatkeqësisht, do të na mungojë Lis Shoshi, i cili do të na kushtojë shumë. Për momentin jam shumë mirë dhe shpresoj të jetë kështu deri në fund", ka shtuar Morina. Ai ka folur për gjasat e Kosovës në parakualifikimet e "Euro 2025". "Danimarka është një përfaqësuese cilësore, ndërsa për Norvegjinë nuk kam shumë informacion, por ne do të bëjmë më të mirën tonë. Shpresoj në paraqitje të mira. Më gëzon fakti që ndeshjen e dytë do ta luajmë në shtëpi përballë 'dardanëve'. Ne do të luajmë për fitore në dy ndeshje, pastaj varet nga forma dhe hollësitë e tjera".
Një nga lojtarët më të rëndësishëm të Kosovës ndihet shumë mirë kur "Dardanët" janë në tribuna. "Është kënaqësi të luash pas një kohe të gjatë me tifozë. 'Dardanët' janë një shtysë e madhe për ne, sidomos në çastet e fundit të ndeshjes, ku ndihet lodhja. Është e papërshkrueshme ajo forcë shtesë që na japin tifozët dhe shpresoj të vijnë në numër sa më të madh dhe t'i gëzojmë me fitore", ka përfunduar Morina. Në ndeshjen ndaj Danimarkës do të lejohen 10 % e tifozëve për shkak të masave kundër Covidit në Kosovë.

Kumbulla nuk po pëlqehet nga Mourinho, e ardhmja në Torino

ROMË, 10 NËNTOR - AS Roma nuk e ka nisur siç e kishte parashikuar sezonin nën drejtimin e Jose Mourinhos. Strategu portugez është i pakënaqur me disa futbollistë ndaj dhe ka kërkuar disa ndërhyrje. Mes lojtarëve verdhekuq që mund të largohen është edhe Marash Kumbulla. Mbrojtësi i kombëtares shqiptare mund të ribashkohet me trajnerin që e evidentoi në Serinë A. Ai pëlqehet shumë nga Torino, nga trajneri Juriç. Këtë lajm e raporton "Il Messaggero". Futbollisti shqiptar me siguri do të ishte i interesuar për këtë lëvizje, por mbetet të shihet a mund të arrihet marrëveshja mes klubeve. Kumbulla u ble për gati 20 milionë euro, por tashmë Roma rrezikon ta humbasë për një shumë më të vogël.

Berisha mungon ndaj Letonisë dhe Holandës

OSLO, 10 NËNTOR - Kombëtarja e Norvegjisë ka konfirmuar lëndimin e sulmuesit shqiptar Veton Berisha. Ky i fundit, pas formës së mirë te Vikingu, pranoi ftesën e Norvegjisë për ndeshjet e nëntorit por, fatkeqësisht, ka pësuar lëndim. Norvegjia përmes një komunikate në "Twitter" bëri me dije se të dy futbollistët mungojnë shkaku i lëndimeve. "Veton Berisha dhe Fredrik Bjorkan fatkeqësisht kanë pësuar lëndime dhe nuk do të luajnë ndaj Letonisë dhe Holandës. Zëvendësimet në skuadër nuk janë sjellë ende", ka njoftuar klubi i Berishës. Kujtojmë se te Norvegjia mungon edhe Erling Haaland, qendërsulmuesi që ka pësuar lëndim me Borussia Dortmundin dhe nuk rikthehet këtë vit.

Babai i Tyson Furyt: Djali im i lënduar në bërryl ka dueluar para sfidës me Wilderin

LAS VEGAS, 10 NËNTOR - John Fury, babai i boksierit britanik Tyson Fury, u shpreh se djali i tij ka dueluar i dëmtuar në bërryl në trilogjinë e zhvilluar një muaj më parë në Las Vegas, ku ai mposhti Deontay Wilder më KO në raundin e 11-të. Në këtë sfidë Fury mbrojti titullin kampion bote të peshës së rëndë (kategoria WBC). Sipas John Furyt, Tysoni është dëmtuar dy herë në bërryl gjatë përgatitjeve që ka bërë për këtë sfidë, duke mos qenë në formën optimale. Madje ai shton se Fury ka qenë vetëm në 50 % të formës së tij e, megjithatë, arriti të triumfojë. "Të jem i sinqertë, Tysoni ka pasur vetëm tri javë e gjysmë për t'u përgatitur për këtë sfidë. Ai ka qenë i shtruar në spital, në Liverpool, për t'u kujdesur për bërrylin dhe nuk stërvitej dot. Brenda katër javësh ai bëri mrekullinë, bëri atë që ju të gjithë e keni parë në ring", ka thënë John Fury. "Tysoni nuk ishte në formë për duelin e 9 tetorit, por u përpoqëm të qëndronim pozitivë para sfidës. Kishte shumë probleme fizike dhe për këtë sfidë ai ishte në 50 % të formës. Më herët kaloi edhe koronavirusi, por ia dolëm mbanë", ka shtuar John Fury.

Cikalleshi dhe Roshi: Nuk kemi frikë nga Anglia, luajmë për rezultat pozitiv

TIRANË, 10 NËNTOR - Kombëtarja shqiptare po vijon përgatitjet për dy ndeshjet e fundit ndaj Anglisë dhe Andorrës. Fillimisht kuqezinjtë do ta luajnë ndeshjen e parë në stadiumin e "Wembleyt" ndaj anglezëve më 12 nëntor, ndërsa tri ditë më vonë skuadra e Rejës do të luajë në "Air Albania" me Andorrën. Në prag të sfidës me Anglinë, kanë dalë në një konferencë për mediat Sokol Cikalleshi dhe Odise Roshi. Cikalleshi ka thënë se kuqezinjtë duhet të luftojnë sikurse në ndeshjen kundër Francës për të arritur një rezultat pozitiv. "Goli në 'Wembley', nëse nuk do të jepte rezultat, nuk besoj se do të ndryshonte shumë në aspektin personal timin. Duhet të dimë që nëse do të jemi të gjithë bashkë dhe të nxjerrim më të mirën tonë, atëherë mund të kemi ndonjë shans. Duhet të jemi realistë, diferenca e Anglisë është e nivelit botëror. Duke nxjerrë çka kemi ne dhe duke luftuar si në ndeshjen me Francën ku kemi barazuar, apo me Portugalinë, që ne kemi treguar se mund të arrijmë rezultat. Ka qenë shpirti i

garës dhe harmonia e grupit që na ka bërë ta arrijmë rezultatin. Dhe kjo është rruga e vetme besoj që ne mund të nxjerrim diçka në ndeshjen me Anglinë", ka thënë Cikalleshi.
Ndërsa Odise Roshi ka thënë se të gjithë e dinë kualitetin e Anglisë, por beson se Shqipëria mund të arrijë fitore. "Të gjithë e dimë që me Anglinë është një ndeshje shumë e vështirë. Të gjithë e dinim kualitetin që Anglia ka shfaqur dhe ka, kurse puna e trajnerit, se si do të luajë në fushë, atë po e bëjmë në stërvitje. Ende nuk e ka vendosur me çfarë taktike do të luajmë. Po shpresojmë të bëjë atë që ka bërë gjithmonë dhe kur të futemi të japim më të mirën dhe tani, nëse themi do të fitojmë, këtë kemi thënë gjithmonë. Do të shkojmë në 'Wembley' të luajmë dhe ta japim maksimumin", ka thënë Roshi. "Mrekullitë kanë ndodhur, prandaj janë të bukura. Shpresoj që të ndodhë kjo gjë. Kështu kemi shkuar edhe në Portugali më 2014 dhe i kemi fituar ndeshjet. Tani lojtarët janë në formë, si Cikalleshi që ka qenë edhe lojtari i javës në formacion në Turqi. Ashtu ka edhe lojtarë të tjerë, si Bare, Kumbulla, Ismajli, që luajnë në nivele shumë të mira. Shpresojmë", ka shtuar Roshi.

Kampionët e NBA-s u rikthehen fitoreve, triumfojnë edhe Jazzi e Clippersi

PHILADELPHIA, 10 NËNTOR - Pas një krize rezultatesh, Milwaukee Bucks u rikthye te fitorja në NBA duke i dhënë fund ecurisë negative prej pesë humbjesh në gjashtë ndeshjet e fundit me suksesin në transfertën ndaj Philadelphia 76ers me rezultatin 118-109. Një fitore nën shenjën e grekut Giannis Antetokounmpo për kampionët në fuqi të NBA-së të cilët iu falën 31 pikëve, por edhe 16 reboundeve dhe katër asistimeve të liderit të tyre. U

kthye te fitorja pas dy humbjesh rresht edhe Utah Jazzi që mposhti me rezultatin 110-98 Atlanta Hawksin duke thelluar krizën e skuadrës nga Georgia që pësoi humbjen e 5-të radhazi. Më i miri për skuadrën nga Salt Lake City ishte Donovan Mitchell me 27 pikë. 27 pikët e Damian Lillardit ndërkohë nuk mjaftuan për Portland Trail Blazzersin që u mposhtë në Staples Center nga Los Angeles Clippers 117-109. Për kalifornianët spikatën Paul George me 24 pikë dhe Reggie Jackson me 23 pikë.

REZULTATET

Philadelphia - Milwaukee	109-118
Utah Jazz - Atlanta	110-98
Clippers - Portland	117-109

SHKURT

Barcelona e mendon rikthimin e Alvesit

Dani Alves mund të rikthehet në skuadrën e Barcelonës. Lajmi është bërë me dije nga media braziliane "UOL". Alvesi në këtë mënyrë do të ribashkohet me Xavi Hernandezin, por këtë herë në role të ndryshme. Mbrojtësi i krahut të djathtë është lojtar i lirë, pasi në muajin shtator është larguar nga Sao Paulo. 38-vjeçari ka qenë pjesë e Barcelonës nga viti 2008 deri në vitin 2016, ku regjistroi 247 ndeshje dhe shënoi 14 gola.

Rossi: Jam kampion i dashur nga populli, njësoj si Pantani

Valentino Rossi njësoj si Marco Pantani. Jo vetëm për nga ngjyra e tyre e pëlqyer, e verdha, që e kanë përdorur të dy ikonat e sportit italian, por edhe për faktin se që të dy janë mjaft të dashur nga populli. I këtij mendimi është piloti i MotoGP, që pas 10 ditësh do ta mbyllë karrierën në garat e motoçiklizmit. "Mendoj se unë dhe Marco Pantani jemi kampionë të popullit. Ndihem njësoj si ai. Edhe unë kam pasur vështirësitë e mia, kam kaluar betejat e mia dhe më kanë ndihmuar njerëz të thjeshtë, ata të lokaleve. Pantani më ka magjepsur gjithnjë dhe kur e shoh në fotografi mërzitem që sot nuk është më", ka thënë Rossi. "Ne jemi kampionë që na duan njerëzit e thjeshtë, pasi kemi ditur të jemi si ata, duke qenë idhuj për këta njerëz të thjeshtë e pa shumë pretendime. Unë dhe Pantani jemi njerëz që vijmë nga populli dhe jemi përpjekur ta transformojmë sportin tonë në popullor dhe të dashur për të gjithë", u shpreh Rossi.

Lewandowski: Nuk po mendoj për 'Topin e Artë'

Robert Lewandowski është një nga lojtarët favoritë për të fituar "Topin e Artë", ceremonia e të cilit do të zhvillohet në fund të vitit. Polaku ka reaguar pas zërave se fituesi është vendosur duke iu referuar publikimit të listës nga "France Football" disa javë më parë. "Nuk jam duke menduar për 'Topin e Artë'. Kam ndaluar së menduari. Nuk të ndihmon të mendosh gjithë kohës për të. Çfarëdo që të jetë publikuar në shtyp, e marr me shumë qetësi. Ka më shumë gjëra të rëndësishme në jetë në këto çaste se ai çmim. Do të mendoj për të vetëm kur të vijë dita. Tani jam duke menduar për gjëra të tjera, siç është ecuria me Bayernin dhe kombëtaren me të cilën kam një shans të artë për t'u kualifikuar në Botërorin e ardhshëm", ka thënë Lewandowski.

Casemiro: Do t'u them nipave se kam luajtur me Modriqin dhe Kroosin

Mesfushori i Real Madridit, Casemiro, ka zbuluar shkallën e admirimit të tij për kolegët në mesfushën e Realit, Toni Kroos dhe Luka Modriq, të cilët ai beson se brezat e ardhshëm do t'i nderojnë në vazhdimësi. Reprezentuesi brazilian ka dhënë një intervistë derisa shpjegoi se të luash përkrah dyshes është diçka për të cilën ai do të jetë në gjendje të mburret deri në pleqëri. "Është një privilegj të luaj për kaq gjatë në klubin më të madh në botë dhe mendoj se do të kuptoj me të vërtetë shkallën e asaj që kam arritur vetëm kur e gjithë kjo të përfundojë një ditë", ka deklaruar Casemiro. "Të luash me Modriqin dhe Kroosin është një privilegj. Unë do të vlerësoj faktin që kam luajtur me ta për një kohë të gjatë dhe do t'u them nipërve të mi se kam luajtur me dy lojtarë të jashtëzakonshëm, dy ikona të lojës", ka shtuar Casemiro, i cili e mbështetet Karim Benzeman në garën për "Topin e Artë".

Unitedi nxjerr në shitje Pogban

Mesfushori Paul Pogba në afatin kalimtar të janarit mund të largohet nga Manchester Unitedi, ky është lajmi i fundit që vjen nga Anglia. Sipas "Daily Star", mesfushori francez as që ka ndër mend ta rinovojë kontratën e tij e tij me "djajtë e kuq", kontratë e cila i skadon në përfundim të këtij sezoni. Drejtuesit e klubit, të gjendur përballë këtij fakti, nuk dëshirojnë të rrezikojnë më shumë, për këtë arsye kanë vendosur ta nxjerrin në shitje francezin që në merkaton e janarit, me shpresën që klube si Juventusi apo PSG-ja të paraqesin ndonjë ofertë, për të mos e humbur në fund të sezonit me parametra zero. Me Solskjaerin në stol nuk ka asnjë shans që Pogba të ndryshojë mendim, dukshëm mes tyre ka një krisje totale. Nga ana tjetër drejtuesit e Manchester Unitedit në mënyrë konstante vijojnë t'i japin besim trajnerit duke shtyrë në këtë mënyrë Pogbanë drejt largimit të sigurt. Jo vetëm Juve dhe PSG-ja, Pogba është një emër shumë i pëlqyer edhe në Spanjë, ku Real Madridi ka qenë dhe mbetet i interesuar për t'i siguruar shërbimet e tij.

Kuzhina Qendrore

PRISHTINA

NPL "Kuzhina Qendrore" SHA, në bazë të nenin 21 lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenin 13 lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 14 paragrafi 3 të Statutit të Ndërmarrjes nr.005 të datës 11.11.2020, ,vendimin nr._053._ të datës 09.11.2021 të Bordit të Drejtorëve, më datë 09.11.2021 shpall këtë:

KONKURS

Pozita e punës: Kryeshef Ekzekutiv (1 pozitë).

Kohëzgjatja e kontratës: 3 vite.

Kompensimi: Kompensimi i Kryeshefit Ekzekutiv bëhet nga Bordi i Drejtorëve në bazë të deklaratës mbi politikën e kompensimit të ndërmarrjes.

Orari i punës: I plotë.

Vendi: Prishtinë

Të përgjithshme:
Çdo kandidat për Kryeshef Ekzekutiv duhet të ketë integritet të lartë, i cili i plotëson kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale në bazë të nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në lidhmëri me nenin 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Detyrat specifike dhe përgjegjësitë:

- Bën Planifikimin ,organizimin dhe kontrollimin e afarizmit të Ndermarrjes
- Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes (KE) ka autoritet që të lidhë kontratë për ndërmarrjen, në pajtueshmëri me Ligjin, Statutin dhe Kontratën e Punës, si dhe aktet tjera qeverisëse, përjashtuar rastet e parapara me dispozitat e nenit 192, paragrafi 192.1, pika c, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- Organizimi i Ndërmarrjes bëhet në mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e KE, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet tjera të ndërmarrjes dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve;
- Të gjitha çështjet në lidhje me ndërmarrjen të cilat nuk janë përgjegjësi e Komisionit Komunal të Aksionareve, BD, Komisionit të Auditimit /Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, do të vendosen me përgjegjësitë e KE;
- KE do të ketë autoritet të punësojë apo të largojë nga puna zyrtarët dhe stafin e ndërmarrjes përveç zyrtareve të lartë të cilët zgjidhen nga Bordi i Drejtorëve apo Komisioni i Auditimit;
- Këshillon dhe merr pjesë në Bordin e Drejtorëve, në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes dhe planet e saja strategjike afatgjata;
- T'i ofron kurdo që të jetë e nevojshme dhe së paku një herë në muaj, Bordit të drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarra nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti lidhur me udhëheqjen e veprimtarisë së ndërmarrjes;
- T'i dorëzon, nën përgjegjësin e tij/saj, Bordit të drejtorëve dokumente, shkresa dhe informacione lidhur me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;
- Bën matjen e performancës së ndërmarrjes dhe i ofron BD rregullisht, së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së ndërmarrjes ndaj klientëve të saj;
- Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe alokimin e fuqisë vendimmarrëse të ndërmarrjes, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të të punësuarve në ndërmarrje
- Ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;
- Ofron zyrtarit të auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohen nga ai;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme;
-Për punën e tij/saj i raporton Bordit të Drejtorëve.
-Si dhe te gjitha kompetencat tjera të parapara me ligjet dhe aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Përmbush kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale në bazë të nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në lidhmëri me nenin 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Të ketë përgatitje universitare në fushën ekonomike, juridike apo të tjera të ndërlidhura me aktivitetet në të cilat vepron ndërmarrja; (diplomat e fituara jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT);
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhim të lartë (pozita të larta drejtuese);
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi, me theks të veçantë në Ligjin për NP, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe akteve tjera që rregullojnë veprimtarinë e ndërmarrjes;
- Të ketë shkathtësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathtësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohuri në gjuhen angleze e preferuar.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e Komunës së Prishtinës https://prishtinaonline.com/konkurset .
2. Deklaratën nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike *(forma shkarkohet nga web faqja e* Komunës së Prishtinës https://prishtinaonline.com/konkurset
3. Letër motivuese;
4. Dëshmi mbi shkollimin;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës ;
6. Kopja dokumentit identifikues;
7. Kandidati së bashku me aplikacionin duhet të dorëzojnë edhe vërtetimin nga gjykata kompetente se i njëjti nuk është nën hetime – jo më të vjetër se 6 muaj.
-Çdo përgënjeshtrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Kandidati/ja, duhet t`i dorëzoj këto dokumente në formë të skanuar në email : kuzhinaqendrore@gmail.com

Konkursi është i hapur 30 ditë, nga data 11.11.2021 dhe përfundon më datë 10.12.2021 në ora 24:00.
Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa nënshkruara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NPL " Kuzhina Qendrore" SHA
Adresa: Rr. Agim Ramadani , P.N – Prishtinë, Kosovë, web: email: kuzhinaqendrore@gmail.com tel: +383 44 46 02 23/038 226 549

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "G.L.D. Group" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810419904, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "G.L.D. Group" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810419904 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "G.L.D. Group" L.L.C. in Pristina, has come to the decision to quit its business: nr. 810419904the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "I D K KONSTRUKTION" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811560392, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "I D K KONSTRUKTION" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811560392 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "I D K KONSTRUKTION" L.L.C. in Pristina, has come to the decision to quit its business: nr. 811560392 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "ARBËRIA Caffe" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810034108, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ARBËRIA Caffe" L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810034108 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "ARBËRIA Caffe" L.L.C. in Pristina, has come to the decision to quit its business: nr. 810034108 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Abedin H. Hasani B.I. A.SH.A "Artcom" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80057500 nr fis. 600022595.

▶ Ardian A.Pllana B.I. N.T.SH. "Coal Koso" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70883945 nr fis. 600696530.

▶ Naxhi Abdurrahmani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Selman Frangu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Elbasan Shigjeqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - lX shfmu " Vëllezërit Frashëri " Pllanej.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

ROYAL CROWN
RC cola

ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
- Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues